



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE

Nr..... prot.

Tiranë, më . . 2023

Lënda: Kërkesë për informacion dhe interpretim nga MAS të pikës 2 të VKM-së nr. 338, datë 31.05.2023

Drejtuar: Zonjës Evis Kushi,
Ministër i Arsimit dhe Sportit

E nderuara znj. Ministre!

Në vijim të komunikimeve institucionale në zbatim të VKM-së, nr. 338, datë 31.05.2023 “Për mbylljen e veprimtarisë së Akademisë së Studimeve Albanologjike dhe riorganizimin e njësive kryesore të saj” dhe efekteve që dalin nga ky zbatim, me cilësinë e Senatit ju drejtohem me kërkesën e mëposhtme:

Në VKM-në, nr. 338, pika “2” thuhet: “*Njësitë kryesore ekzistuese, Qendra Kërkimore e Enciklopedisë Shqiptare dhe Botimeve dhe personeli akademik i këtyre njësive, aktualisht pranë Akademisë së Studimeve Albanologjike, riorganizohen si njësi të kërkim-studimit pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, brenda datës 31dhjetor 2023*”.

Për institucionin tonë, për institutet e tij përbërëse, për stafin akademik dhe për kërkimin shkencor në studimet albanologjike, ky përcaktim i përgjithshëm ka krijuar paqartësi juridike dhe administrative lidhur me termat “riorganizohen” dhe “njësi të kërkim - studimit”.

1. Ligji 53/2019 “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë” përdor termin “njësi kërkimi”, e cila sipas tij “është me afat 2-vjeçar ose afatgjatë”, por jo një njësi e rregullt (d.m.th. e përhershme).

2. Neni 19 i Ligjit 53/2019 dhe as Ligji në tërësi nuk përmbajnë dhe nuk përcaktojnë të dhëna mbi strukturën organizative të brendshme të njësive të kërkimit, nuk përcaktohet numri i anëtarëve dhe as statusi ligjor i kërkuesve shkencorë etj.

Sjellim në vëmendjen Tuaj se

1. Katër njësitë kryesore të ASA-së: Instituti i Arkeologjisë, Instituti i Antropologjisë dhe i Studimit të Artit, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë dhe Instituti i Historisë janë njësi të rregullta pranë ASA-së dhe ndryshimi i strukturës së tyre është parashikuar në mënyrë të detajuar në ligjin Nr. 80/2015, si dhe në Statutin dhe Rregulloren e ASA-së, të miratuara nga MAS-i sipas ligjit.

2. Secila nga njësitë kryesore pranë ASA-së përbëhet nga tri njësi-bazë [departamente] dhe secila njësi-bazë dhe ajo kryesore zgjedh drejtuesit e saj për një mandat të përcaktuar.

3. Secila njësi bazë [departament] përbëhet nga jo më pak se 7 anëtarë.

4. Paqartësia e krijuar nga pika 2 e VKM-së 33/2023 ka sjellë shqetësim të drejtë tek ASA, edhe për angazhimet tona institucionale në raport me marrëveshjet e bashkëpunimit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, për projektet shkencore afatmesme e afatgjata, dhe aktivitetet shkencore përkatëse, të miratuara në fillimin e vitit 2023.

Mbi këtë bazë, Senati vendosi t'ju drejtohet Juve si autoriteti ekzekutiv vendimmarrës, të na mundësoni:

1. Shpjegimin juridik për konceptin “riorganizim i njësive kryesore si njësi kërkim-studimi”.

2. Informacion, nëse, në kuadër të zbatimit të VKM-së 338/2023, do të ketë *Njësi-bazë* si pjesë përbërëse të një *Njësie kryesore* dhe nëse *Njësia e kërkim-studimit* është e njëjtë me kuptimin e dhënë për “Institut” në ligjin nr. 80/ 2015 dhe në Statutin në fuqi të ASA-së, të miratuar nga MAS.

3. Sqarim rreth transferimit të administratës së ASA-s, e cila nuk përmendet fare në VKM-në 338/2023. Ju bëjmë me dije se në këtë administratë janë mbi 20 punonjës.

Zonja Ministre,

Duke dëshmuar gatishmërinë tonë të plotë për të përmbushur përgjegjësitë tona akademike dhe kërkimore, si dhe angazhimet ligjore dhe administrative, bazuar në parimet kushtetuese të autonomisë, të lirisë akademike dhe të shtetit të së drejtës, Senati i ASA mbetet në dispozicion të komunikimit institucional dhe në pritje të përgjigjes zyrtare nga MAS-i.

Me konsideratë,

KRYETARI I SENATIT

Akad. prof. dr. Valter Memisha